



NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE "EKOSISTEMI" SH.A., SHTIME
Nr - 01/03 datë:15.12.2025

Në bazë të Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 për Punën, si dhe neneve 5 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Ndërmarrja Publike NPL "EKOSISTEMI" SH.A., me datën 15.12.2025 shpall këtë:

KONKURS

PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Pozita: Shef / Mbikëqyrës i njësië Operative (1 pozitë);
Vendi i punës: Ndërmarrja Publike Lokale "Ekosistemi" SH.A – Shtime
Kohëzgjatja e kontratës: Me kohë të caktuar (1 vit) me mundësi vazhdimi, puna provuese zgjatë deri në gjashtë (6) muaj;
Orët e Punës: 40 orë në javë
Paga: 755.00 Euro/Bruto

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara për pozitën:

- Dëshmi të shkollimit: Shkollë e Mesme ose Diplomë Universitare;
- Dëshmi të kualifikimit profesional; diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara;
- Patentë shoferi, kategoria B;
- Përvojë pune prej të paktën 1 (një) viti në pozita mbikëqyrëse ose menaxheriale, e dëshmuar me pasqyrën e Trustit Pensionar;
- Aftësi për punë nën presion, me etikë të lartë dhe integritet profesional;
- Gatishmëri për punë me orar fleksibël.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Organizon dhe mbikëqyr të gjitha operacionet e njësive të Ndërmarrjes.
- Harton dhe elaboron plane dhe programe lidhur me mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbëruara.

- Udhëheq dhe mban evidencën e gjithëmbarshme të punëtorëve të njësive të Ndërmarrjes.
- Harmonizon dhe programon bilancet materiale dhe punuese për njësitë punuese me qëllim të rritjes së efikasitetit në punë.
- Kontakton me kryepunëtorët dhe bën mbikëqyrjen e punës së objekteve.
- Përcjell vazhdimisht të gjitha punët e njësive punuese.
- Kryen të gjitha punët e tjera që janë lëndë e afarizmit të njësive punuese.
- Bën rregullimin e orareve të punëtorëve.
- Është i/e orientuar drejt detajeve dhe në gjendje të mbajë nivel të lartë të përgjegjësisë.
- Sipas nevojës kryen edhe detyra të tjera të caktuara nga Kryeshefi.
- Është i obliguar të ketë sjellje korrekte duke respektuar kolegët.
- Mban regjistrin e mjeteve të punës dhe inventarit të Ndërmarrjes.
- Ngarkon punëtorët me mjete të punës dhe është përgjegjës për autoparkun e Ndërmarrjes.
- Kryen edhe detyra të tjera relevante.
- I raporton Kryeshefit/Shefes Ekzekutiv të NPL “Ekosistemi” Sh.A., Shtime.

Kandidatët duhet të paraqesin këto dokumente:

- Aplikacionin (mund të shkarkohet në faqen zyrtare të Komunës së Shtimes ose merret fizikisht në sportel);
- Dëshmi mbi kualifikimin shkollor;
- Dëshmi mbi përvojën e punës;
- Certifikatë që vërteton se nuk jeni nën hetim nga Gjykata (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- Kopje e letërnjoftimit.

Procedura e konkurimit

- Dokumentacioni i aplikantëve duhet të dorëzohet në sportelin e Komunës së Shtimes (Zyra Pritëse), kati përdhësë, nga ora 08:00 deri në 16:00, dhe të jetë i adresuar në:
- **Konkurs – (Shef / Mbikëqyrës i njësië Operative)**
- **NPL “EKOSISTEMI” SH.A. Shtime**
- Të gjitha dokumentet duhet të jenë të vendosura në një zarf të mbyllur.
- Kandidatët që i plotësojnë kushtet formale do të ftohen në intervistë verbale.
- Kandidati që ftohet në intervistë është i obliguar t’i paraqesë para Bordit dokumentet origjinale të kërkuara.
- Çdo deklaram i rremë, qoftë i qëllimshëm apo si pasojë e pakujdesisë, si dhe çdo ndryshim material i informatave të dhëna në deklaratën nën betim, sjell skualifikim të menjëhershëm nga procedura.

Vemendje:

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Shpallja është e hapur nga data 15.12.2025 deri më 13.01.2026 në orën 16:00.



Kryeshefi Ekzekutiv

Besart Aliu